



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT
TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 61, QARKU FIER, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 06.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 61, Qarku Fier, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.296 datë 10.05.2019, ka miratuar caktimin e VNV së KZAZ nr.61 në "Sallën e Kinemasë, Pallati i Kulturës "Dino Kalenja", Ballsh, me sipërfaqe 250 m², sipas propozimit të bërë nga Prefektura e qarkut Fier.

Prefekti i qarkut Fier me shkresën nr.7518 datë 05.06.2019, propozon ndryshimin e vendndodhjes së VNV-së së ZAZ nr. 61 duke e caktuar në Shkollën e Mesme të Përgjithshme "Dervish Hekali" (palestra), sipërfaqe 486 m², Bashkia Mallakastër.

Ndryshimi kërkohet për shkak se Pallati i Kulturës "Dino Kalenja" është në rikonstrukcion, dhe punimet nuk përfundojnë përpara datës 30 qershor.



Nr. 803 i Vendimit Data 06.06.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 61, Qarku Fier, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

Shkolla e Mesme e Përgjithshme "Dervish Hekali", ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, për caktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit.

ZAZ nr. 61 ka në juridiksionin e saj 57 QV, dhe në bazë të përcaktimeve të Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015, duhet të ketë sipërfaqe prej jo më pak se 200 m2.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 61, në Shkollën e Mesme të Përgjithshme "Dervish Hekali", me sipërfaqe 486 m2, Bashkia Mallakastër.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 803 i Vendimit Data 06.06.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 61, Qarku Fier, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019